



## Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

### LAJMËRIM PARAPRAK

**për publikim të Thirrjes publike numër 01/2022 për parashtrim të kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga masa 3 “Investime në mjete fillestare për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkatarisë” nga sfera e politikave për bujqësi dhe zhvillim rural të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2014-2020)**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në gjysmën e dytë të muajit korrik 2022 do të shpallet Thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga **masa 3 “Investime në mjete fillestare për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkatarisë”** nga sfera e politikave për bujqësi dhe zhvillim rural të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2014-2020).

Qëllimi i IPARD Programit 2014-2020 është përmes masave përkatëse për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektorit bujqësor-ushqimor, përmes harmonizimit të tyre me standardet e Bashkimit Evropian dhe arritjes së ambientit të qëndrueshëm jetësor dhe zhvillim socio-ekonomik në mjediset rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2014-2020 në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga korriku 2022 dedikohen për mbështetje të të gjitha sektorëve nga **masa 3 “Investime në mjete fillestare për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkatarisë”**.

Të pranueshme për bashkëfinancim do të jenë shpenzimet për prokurimin e pajisjeve dhe shërbimeve me përjashtim të kostove të ndërtimit. Për investimet në "Prokurimin e pajisjeve për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme" vendosje/instalimi i paneleve fotovoltaike do të jetë një kosto e pranueshme. Duke marrë parasysh specifikën e thirrjes publike për shkak të afatit kohor për realizimin e aktiviteteve nga Programi IPARD 2014-2020, "Vendimin për vendosjen e paneleve fototensionale për prodhimin e energjisë elektrike me kapacitet maksimal të instaluar deri në 1 MW kërkuesit do të duhet të dorëzojnë gjatë vetë aplikimit.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020 udhëzojnë lidhjen paraprake të kontratës së shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuara paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë së Veriut për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Bashkimit Evropian.

Duke marrë parasysh specifikën e thirrjes publike për shkak të afatit kohor për realizimin e aktiviteteve nga Programi IPARD 2014-2020, njoftojmë të gjithë përfutuesit e interesuar potencial se afati i fundit për realizimin e investimeve që do të bashkëfinancohen me këtë Thirrje Publike është 30.05.2023, dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pagesë është 30.06.2023.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e mbështetjes financiare nga IPARD Programi 2014-2020 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

Shpallja do të zgjasë së paku **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në gazetata ditore.

**VËREJTJE:** Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit në lidhje me masën 3 “Investime në mjete fillestare për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkatarisë” nga IPARD Programi 2014-2020 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informacione më të hollësishme në lidhje me llojet e investimeve, kriteret për fitimin e mbështetjes financiare dhe shuma e mbështetjes, të interesuarit mund t'i marrin në Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Telefoni: 02 3097-460  
Faksi: 02 3097-454  
e-mail adresa: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)  
[www.pa.gov.mk](http://www.pa.gov.mk)

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Sektori për udhëheqje me IPARD  
Telefoni: 02 3134-477 lok: 113, 114 dhe 115  
e-mail adresa: [info@ipard.gov.mk](mailto:info@ipard.gov.mk)  
[www.ipard.gov.mk](http://www.ipard.gov.mk)

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi  
Telefoni: 047 228-330  
Faksi: 047 228-370  
[www.agencija.gov.mk](http://www.agencija.gov.mk) çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

